




BiEPAG



## Nuk votoni më “për djallin që njihni”?

**Pse problemi i veprimit kolektiv në Ballkan mund të jetë më i thjeshtë për t’u zgjidhur nga sa mendojmë**

Rezultatet e zgjedhjeve të fundit kanë hedhur poshtë nocionin se zgjedhjet në Ballkan nuk janë në gjendje të sjellin ndryshim. A i është përgjigjur publiku kësaj? Argumentohet se pavarësisht pengesave të dukshme ku opozitarët duan të mundin zyrtarët në pushtet, opinioni publik varet nga përvojat e kohëve të fundit në secilin vend. Sapo t’u tregohet rruga dhe pavarësisht një periudhe të gjatë ngërçi (apo edhe kapje të shtetit), qytetarët fillojnë të besojnë se ndryshimi është i mundur. Gjetjet e këtij dokumenti tregojnë se, në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhje, problemi i “veprimit kolektiv” në Ballkan –që mund të përkufizohet si mungesa e besimit të mundësia për ndryshim dhe që çon në zhgënjime me procesin demokratik dhe në mungesën e vullnetit të njerëzve për të vepruar me qëllim që të bëjnë të mundur ndryshimin– mund të mos jetë edhe aq i vështirë për t’u zgjidhur nga sa ç’thuhet në hulumtimet e mëparshme

Tena Prelec dhe Jovana Marović <sup>1</sup>

## Hyrje

Në Evropën Juglindore, zgjedhjet shpesh etiketohen si perde e dritares së demokracisë, ku të njëjtat elita bëjnë rokadë pushteti pa pushim. Gjithsesi, votimet e fundit e kanë hedhur poshtë këtë nocion. Pas më shumë se 30 vjet në pushtet, Milo Gjukanović duhet të pranonte humbjen në zgjedhjet parlamentare të gushtit 2020 dhe t'i dorëzonte pushtetin një koalicioni të gjerë partish, të cilat, edhe pse mes tyre kishin shumë mosmarrëveshje ideologjike, ato kishin një qëllim të përbashkët: rrëzimin e regjimit të vjetër. Megjithatë, Mali i Zi nuk është i vetmi shtet ku u shkëlqen vendit status kuoja. Në nëntor 2020, zgjedhjet vendore në Bosnjë dhe Hercegovinë sollën rezultate të papara: në shumë bashki, qytetarët refuzuan kandidatët nga tre partitë kryesore etnike dhe mbështetën aktorë të jashtëm politikë. Një vit më parë, edhe votuesit kosovarë refuzuan partitë kryesore politike dhe kurorëzuan një lëvizje të hershme opozitare (Vetëvendosje) si fituesin relativ të zgjedhjeve. Për një arsye apo tjetër, aksioma e vjetër "votojmë më mirë për djallin që njohim" duket se nuk funksionon më.

A po duket ndryshimi në horizont dhe, nëse po, sa mund të zgjasë ai? Si po i përgjigjet publiku sfidave të vjetra dhe të reja që lidhen me procesin zgjedhor? Duke u mbështetur në një sondazh publik të kryer me një kampion përfaqësues kombëtar të qytetarëve në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, në diskutimin që vijon do të trajtohen pyetje që lidhen me tre tematika kryesore: besimi në procesin zgjedhor për të sjellë ndryshime; qëndrimet ndaj opozitës politike dhe metodave të saj; dhe pikëpamjet e qytetarëve për votimin e emigrantëve.

Kështu, ky dokument politikash trajton potencialin e brendshëm të zgjidhjes së 'problemit të veprimit kolektiv'.<sup>2</sup> Kostot e larta që i dalin çdo individ ku ndërmer veprime me qëllim sjelljen e ndryshimeve si dhe mundësitë e pakta të perceptuara për sukses ulin gjasat që qytetarët në vendet me regjim autoritar apo gjysmë-autoritar të shprehin pakënaqësitë e tyre ndaj regjimit.

Siç kanë treguar edhe studimet, qytetarë zgjedhin të mos e sfidojnë qeverinë e tyre në rrethana të tilla.<sup>3</sup>

Ndonëse individët mund të kenë më shumë përfitime nga bashkëpunimi në grup, ata nuk arrijnë të bëhen bashkë, sepse pengesat e perceptuara janë aq të mëdha sa që detyrohen t'i kthehen pjesëmarrjes në mekanizma që përjetësojnë problemet e vjetra dhe, shpesh, strukturave të vjetra të pushtetit (si praktika klienteliste apo abstenim në votime). Ndërkohë që hulumtimet e mëparshme kanë analizuar aftësinë e aktorëve të jashtëm, si BE dhe SHBA<sup>4</sup>, për të zgjidhur problemin e veprimit kolektiv dhe për të sjellë ndryshime përmes zgjedhjeve, reagimi qytetar në këtë kontekst është anashkaluar dukshëm. Faktet që analizohen në këtë dokument na ndihmojnë të ngremë pyetje për hamendësimet e deritanishme.

## Besimi në procesin zgjedhor: a mund të sjellin zgjedhjet ndryshim?

Në vitin 2020, në arenën politike të rajonit pati disa ndryshime të mëdha, ku më e papritura ishte sigurisht ajo në Mal të Zi, vend në të cilin në zgjedhjet parlamentare të muajit gusht dhe pas më shumë se tre dekadash, opozita fitoi mundësinë për të krijuar një qeveri që për herë të parë nuk do të kishte në të Partinë Demokratike të Socialistëve (DPS) të Milo Gjukanovićit. Ky rezultat ndikoi në ndryshimin e perceptimit të qytetarëve për zgjedhjet si mjet që sjell ndryshim: 80% e malazezëve tashmë besojnë në atë që për ta deri para pak muajsh ishte e paimagjinueshme:<sup>5</sup> që qeveria mund të zëvendësohej me anë të zgjedhjeve. Kjo është një përqindje mjaft e lartë në krahasim me pjesën tjetër të rajonit. Po kjo shifër është në nivelin 43% në Bosnjë-Hercegovinë si dhe në Serbi dhe vetëm 38% në Shqipëri. Në mes tyre kemi dy vende që kanë përjetuar në gjysmë dekadën e fundit, në një formë a një tjetër, ndryshime në përbërjen e qeverisë si rezultat i zgjedhjeve: Kosova (56%) dhe Maqedonia e Veriut (46%).

1 Autorët dëshirojnë të falënderojnë Dr. Milica Delević dhe Prof. Elizabeth David-Barrett për komentet e tyre.

2 Mancur Olson, *The Logic of Collective Action: Public Goods and the Theory of Groups*, (Logjika e veprimit kolektiv: Të mirat publike dhe teoria e grupit) 1971, Harvard University Press.

3 Joshua A. Tucker, "Enough! Electoral Fraud, Collective Action Problems, and Post-Communist Colored Revolutions", *Perspectives on Politics*, Volume 5, Issue 3, September 2007, pp. 535 - 551.4 Krastev, Ivan (2008), "Europe's other legitimacy crisis", *Open Democracy*.

4 Petrova, Tsveta, "Diffusion brokers and regime change waves: The US role in the wave of Central and Eastern European Electoral Breakthroughs" (Ndërmjetësit e përhapjes dhe valët e ndryshimeve të regjimeve: Roli i ShBA-ve në valën e përparimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore), *Demokratizatsiya*, Vol. 26, Nr. 2, (Pranverë 2018): 227-250.5

5 Në një sondazh të opinionit publik të kryer në korrik 2020, shumë pak para zgjedhjeve parlamentare të gushtit në Malin e Zi, evidentohej se vetëm 49.5% e të anketuarve besonin se zgjedhjet do të ishin të lira dhe të ndershme, ose plotësisht ose me rezerva, ndërsa 41.7% e të anketuarve mendonin se këto zgjidhje nuk do të ishin të lira dhe të ndershme, ndërkohë që 8.7% nuk dhanë përgjigje. Shihni: "Mes nevojave dhe ofertave politike: A mund të ketë zgjedhje të vërteta për qytetarët e Malit të Zi?", Qendra për Edukim Qytetar, korrik 2020, <http://media.cgo-cce.org/2020/07/CGO-FES-Izmedju-potreba-i-politickih-ponuda-2020.pdf>






Tabela 1. Besimi se qeveria mund të ndryshohet me anë të zgjedhjeve

Një besim i tillë i ulët në aftësinë e qytetarëve për të marrë pjesë realisht në proceset demokratike duhet të shihet në lidhje me pengesën më të madhe të perceptuar ndaj zgjedhjeve të lira dhe të ndershme: presioni ndaj votuesve. Suksesi në zgjedhje i partive të opozitës varet kryesisht nga numri i qytetarëve që kanë frikë se mos humbasin përfitimet që kanë nëse nuk votojnë për partinë në pushtet.<sup>6</sup> Votimi me detyrim në këmbim të favoreve të njëhershme, përfitimeve sociale dhe punësimit në administratën publike janë mekanizma që përdoren më shpesh për të ndikuar dhe për të ushtruar presion mbi votuesit.<sup>7</sup> Ky presion është pengesa më e madhe e perceptuar ndaj zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, kjo pengesë është më pak e dukshme në Shqipëri dhe Serbi, ku vetëm 21% e të anketuarve në Shqipëri dhe 27% në Serbi, në krahasim me 43% në Malin e Zi, thanë se presioni ndaj votuesve është problem për ta. Kjo mund të shpjegojë, të paktën pjesërisht, popullaritetin e partive në pushtet në Shqipëri dhe Serbi: nëse situata u shkon për mbarë votuesve, ata janë më pak të prirur për t'u ankuar për të. Megjithatë, duhet theksuar se në të gjitha vendet e rajonit, përveç Shqipërisë (ku kjo përqindje ishte paksa më e ulët dhe rrinte në nivelin 48%), shumica dërrmuese e të anketuarve thanë se nuk kishin përjetuar kurrë personalisht asnjë lloj presioni që lidhej me zgjedhjet. Qytetarët besojnë se forma më e zakonshme e

presionit ndaj votuesve është punësimi politik, d.m.th., premtimi për një vend pune apo kërcënimi për humbjen e vendit të punës (që varion nga 26% e të anketuarve në Shqipëri në 57% në Kosovë).

Pavarësisht besimit të një përqindjeje të madhe të të anketuarve se zgjedhjet nuk mund të sjellin ndryshim të madh, qytetarët thanë se marrin pjesë rregullisht në to. Në të gjitha vendet e vëzhguara, më shumë se gjysma e të anketuarve thanë se shkojnë rregullisht në votime: përqindje që varion nga 69% (në Shqipëri) në 85% (në Malin e Zi). Zgjedhjet e fundit në Malin e Zi e konfirmuan këtë: pavarësisht krizës për shkak të koronavirusit, pjesëmarrja ishte shumë e lartë, duke tejkaluar 76%, që ishte një nga faktorët që çoi në ndryshimin e qeverisë. Gjithsesi, për një pjesëmarrje kaq të lartë kanë ndikuar shumë faktorë<sup>8</sup>. Në disa vende, ka një mospërputhje të madhe mes rezultateve të sondazhit të opinionit publik dhe pjesëmarrjes së regjistruar në zgjedhje. Për shembull, në Bosnjë dhe Hercegovinë, rreth 83.9% deklaruan se marrin pjesë në votim, por pjesëmarrja e regjistruar zyrtarisht në zgjedhjet vendore në nëntor 2020 zor se e kaloi 50%. Nuk është hera e parë që evidentohet kjo mospërputhje shifrash në zgjedhjet vendore dhe në ato kombëtare. Ndonëse raportimi i tepruar i sjelljes së votuesve është një arsye e mundshme, organizatat që merren me monitorimin e zgjedhjeve në Bosnjë dhe Hercegovinë pohojnë se shpjegimi për këtë

6 Gentiana Kera dhe Armanda Hysa, "Ndikimi i votës, fitimi i zgjedhjeve: praktikat klienteliste dhe financimi privat i fushatave zgjedhore në Shqipëri", Southeast European and Black Sea Studies, Vëllimi 20, Numri 1, Janar 2020, fq. 123-139

7 Marko Kmezić dhe Florian Bieber, red. "The Crisis of Democracy in the Western Balkans. An Anatomy of Stabilitocracy and the Limits of EU Democracy Promotion" (Kriza e demokracisë në Ballkanin Perëndimor. Anatomia e stabilitokracisë dhe limitet e promovimit të demokracisë së BE-së), BiEPAG, mars 2017, fq. 15-33 <http://biepag.eu/wp-content/uploads/2019/03/TheCrisisofdemocracy.pdf>

8 Jovana Marovic „Chess games after the 2020 elections in Montenegro – Black on White“ (Lojëra shahu pas zgjedhjeve 2020 në Malin e Zi – I ziu mbi të bardhë), Observatori Tirana, 8 tetor 2020, <https://tiranaobservatory.com/2020/10/08/chess-games-after-the-2020-elections-in-montenegro-black-on-white/>



enigmë duhet të kërkohet, të paktën pjesërisht, në listat e vjetëruara të votuesve.<sup>9</sup> Numri i lartë jorealit i votuesve në këto lista, i lidhur me emigracionin e lartë, është problem në të gjithë rajonin. Del më se e nevojshme që të pastrohet regjistri zgjedhor, siç sugjerohet nga analiza të përsëritura dhe tashmë të bëra pjesërisht në disa vende (p.sh. në Maqedoninë e Veriut)<sup>10</sup>.

Apatia e votuesve nxitet nga motive që ndryshojnë disi nga njëri vend në tjetrin. Qytetarët që nuk marrin pjesë në procesin e votimit citonin disa arsye kryesore për vendimin e tyre: në Shqipëri, motivi kryesor është mungesa e interesit në procesin e votimit (34%). Parregullsitë në zgjedhje, që çon në besimin se zgjedhjet janë përcaktuar paraprakisht, është arsyeja që u citua më shpesh në Bosnjë dhe Hercegovinë (33%). Maqedonasit, nga ana e tyre, ankohen se nuk kanë për kë të votojnë (30%). Këto të dhëna evidentohen nga një përqindje e ulët e të anketuarve që deklarojnë se marrin pjesë në protesta ose në grupe vendore aktivistësh.<sup>11</sup> Në

aspektin pozitiv, besimi se vota e dikujt nuk do të ndryshojë asgjë është, në terma relativë, opsioni më pak i popullarizuar: varion nga 5% (Shqipëri) në 20% (Serbi) e të anketuarve që nuk shprehin interes në procesin e votimit. Këto të dhëna na tregojnë, përsëri, se interesi i qytetarëve në procesin zgjedhor mund të jetë më i lartë nga sa vlerësohet në përgjithësi.




Tabela 2: Arsyja për abstenimin në votime

9 Jovana Marović, Tena Prelec, Marko Kmezić "Strengthening the Rule of Law in the Western Balkans: Call for a Revolution against Particularism" (Forcimi i shtetit ligjor në Ballkanin Perëndimor, Thirrja për një revolucion kundër partikularizmit), BiEPAG, janar 2019, fq. 38-39, <http://biEPAG.eu/wp-content/uploads/2019/03/Strengthening-the-Rule-of-Law.pdf>

10 "Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut 2020", tetor 2020, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north\\_macedonia\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf)

11 Marika Djolai "Social (dis)connectedness in the Western Balkans. Civic engagement in the age of failed democracy" (Shkëputja me lidhjet sociale në Ballkanin Perëndimor. Angazhimi civil në epokën e demokracisë së dështuar), BiEPAG, janar 2021



## Opozita politike dhe pakënaqësia: A funksionon bojkoti?

Është një fakt i njohur se besimi te qeverisja dhe institucionet në Ballkanin Perëndimor është shumë i ulët në të gjithë vendet e rajonit.<sup>12</sup> Edhe opozita politike nuk është se gëzon ndonjë besim të madh. Në të gjitha vendet e vëzhguara, përveç Kosovës, shumica relative e të anketuarve besojnë se opozita nuk është e mirë organizuar. Të kombinuar në total, rreth 48% besojnë se opozita është krejtësisht e çorganizuar (22.3%) apo ka organizim të dobët (25.5%), krahasuar me totalin e përgjithshëm prej rreth 38% që mendojnë se opozita ka organizim mesatar (23%) apo të mirë (15.6%). Gjykimi më i ashpër për opozitën politike regjistrohet në Serbi, ku 84% kanë një opinion të keq për efektivitetin e saj, teksa 43% e konsiderojnë atë si tërësisht të çorganizuar. Në Kosovë, ku partitë e “jashtme” dhe figurat politike arriten fitore të konsiderueshme në zgjedhje në këto vitet e fundit, si për krahasim, kjo shifër është tejte e ujët: vetëm 13.4% mendojnë se opozita është tërësisht e çorganizuar, ndërkohë që 33.9% mendojnë se ajo është e mirë organizuar (dhe një 19.4% e të anketuarve që mendojnë se opozita është mesatarisht e mirë organizuar). Ndër arsyt kryesore të besimit të ulët në punën e opozitës, qytetarë evidentuan se ajo nuk është e bashkuar, nuk ka udhëheqës, mendon vetëm për interesat e saj, dhe funksionon me mangësi në kapacitete dhe infrastrukturë dhe/ose i mungon një platformë apo program i qartë.

Në përgjithësi, bojkoti i zgjedhjeve nuk gëzon mbështetje të gjerë: 56.2% e të anketuarve thanë se nuk e mbështesin bojkotin si mjet të luftës politike kundër zgjedhjeve të parregullta, ndërsa 32.2% thanë se e mbështesin atë. Megjithatë, kjo përqindje ndryshon sipas vendeve. Në Serbi, bojkoti nga opozita i zgjedhjeve të qershorit 2020 nuk prodhoi rezultate pozitive të prekshme për të, ndërkohë që vetëm 25.8% shprehën mbështetje për këtë taktikë. Si për krahasim, në Maqedoninë e Veriut plot 47.8% e të anketuarve e konsideronin bojkotin si taktikë të preferuar. Përvoja e këtij vendi si pasojë e skandalit të përgjimeve në 2015, përfshirë edhe rekomandimet e dhëna në raportin Priebe,<sup>13</sup> solli një përmirësim të

pjesëshëm të fushës të lojës si për partinë në pushtet ashtu edhe për opozitën, duke sjellë si rezultat qeveri të përkohshme dhe ndryshim të mëposhtëm të elitës sunduese nëpërmjet kutive të votimit në fund të 2016-2017. Siç duket qartë, opinioni i qytetarëve në lidhje me efektivitetin e opozitës dhe përdorimin e bojkotit, në të dy rastet, varet nga përvojat më të fundit me zgjedhjet dhe nuk mund të jetë i pandryshueshëm gjithsesi.

## Emigrimi dhe pjesëmarrja politike: çfarë dimë për votën emigrantëve që jetojnë jashtë vendit?

Në të gjitha vendet, shumica e qytetarëve mendojnë se vota e diasporës në një numër më të madh do të ndikonte në mënyrë të konsiderueshme në rezultatet e zgjedhjeve, me përqindjen më të lartë të regjistruar në Mal të Zi, 75%<sup>14</sup> dhe e ndjekur nga Kosova, 63%. Shumica e të anketuarve e konsiderojnë votimin e diasporës të papërcaktuar qartë me ligje, me përqindjen më të lartë në Bosnjë dhe Hercegovinë, 65%. Po ashtu, është interesante që në Kosovë, arsyeja pse një përqindje relativisht e madhe e njerëzve (36%) e konsiderojnë të rregulluar mirë me ligj votimin e emigrantëve është se diaspora ka të drejtë vote. Në Shqipëri, për shembull, askush nga të anketuarit nuk e zgjodhi këtë arsye (me sa duket, sepse pakënaqësia me votimin e emigrantëve është shumë e lartë). Më e rëndësishmja, fakti që një shumicë relative e të anketuarve, të cilët deklaruan se vota e diasporës është e rregulluar mirë me ligj nuk japin në të njëjtën kohë një arsye të vetme për të shpjeguar zgjedhjen e tyre, është një tregues i qartë se qytetarët nuk dinë sa duhet për këtë temë.

12 “Balkan Barometer 2020 - Public Opinion Analytical Report”, 2020, <https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications>.

13 “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve për çështje të sistemit të shëtit ligjor në lidhje me përgjimin e komunikimeve të zbuluara në pranverë 2015”, Bruksel, 8 qershor 2015, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf)

14 Edhe pse në Malin e Zi shumica e re qeverisëse u krijua në gusht 2020, qeveria e re u betua vetëm në dhjetor, ndaj ky informacion me shumë gjasa i referohet partisë që kishte shumë vite në pushtet në Malin e Zi (DPS), për të cilën diaspora votonte ‘tradicionalisht’.






Tabela 3: Opinione pse votimi jashtë vendit është i rregulluar mirë me ligj

Vota e diasporës është një temë shumë pak e diskutuar në debatin publik. Studimet kanë treguar se edhe ata emigrantë nga Ballkani që duan të marrin pjesë në procesin zgjedhor nga jashtë vendit janë të paqartë në lidhje me procedurën e votimit dhe shpesh hasin pengesa për të hedhur votën e tyre.<sup>15</sup> Prandaj, siç tregojnë të dhënat e sondazhit tonë, është logjike që qytetarët që kanë qëndruar në vendin e tyre të origjinës të kenë njohuri shumë të kufizuara në lidhje me këtë çështje. Ata të anketuar që besojnë se votimi nuk është i rregulluar mirë me ligj nuk kanë ndonjë ide të qartë se si mund të përmirësohet ky votim, me përjashtim të Malit të Zi, ku sugjerimi kryesor është heqja e të drejtës së votës për diasporën<sup>16</sup>. Votimi jashtë vendit është një temë që është shtyrë prej shumë kohësh në disa vende, pikërisht nga frika se

një rregullim më i mirë ose i ndryshëm me ligj i këtij aspekti mund të ndikojë në proceset politike dhe ndoshta mund të çojë në ndryshim të qeverisë (p.sh. në Shqipëri).<sup>17</sup> Duke pasur parasysh se të dhënat për emigracionin janë të paplota, kjo temë duhet të jetë një pjesë e rëndësishme e diskutimeve për reformën zgjedhore në çdo vend të Ballkanit Perëndimor.

## Përfundime

Pavarësisht opinionit të përhapur se zgjedhjet nuk mund të bëjnë diferencën e vërtetë, për shkak të avantazheve të jashtëzakonshme të pushtetmbajtësve në drejtime si aksesit të burimeve publike dhe kontrollit të medias,<sup>18</sup> votimet e fundit në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë treguar se

15 Tena Prelec, "The Serbian Diaspora's Political Views: A Study on the 2017 Serbian Presidential Election" (Pikëpamjet politike të diasporës serbe: studim i zgjedhjeve presidenciale serbe të 2017), Revista për Studimet për Ballkanin dhe Lindjen e Afërt, Vëllimi 21, 2019 – Numri 1: Migrimi në Ballkanin Perëndimor: Çfarë dimë?

16 Ky është një rast specifik, ndoshta për shkak të polemikave që bëhen për vite me radhë rreth asaj se kush ka të drejtë të votojë në zgjedhjet në Malin e Zi, duke qenë se ka interpretime të ndryshme të Ligjit për Zgjedhjen e Këshilltarëve dhe Anëtarëve të Parlamentit. Ky ligj thotë se e drejta për të marrë pjesë në zgjedhje i takon çdo personi që ka jetuar në Malin e Zi për të paktën dy vjet para zgjedhjeve, kështu që shumë parti politike pretendojnë se është antikushetuese të zgjatet e drejta e votës për ata që kanë jetuar jashtë Malit të Zi për shumë vite.

17 Exit, "Diaspora shqiptare dhe vota e diasporës", 11 nëntor 2020 <https://exit.al/en/2020/11/11/exit-explains-the-albanian-diaspora-and-the-diaspora-vote/>

18 Jovana Marović, Tena Prelec, Marko Kmezić "Strengthening the Rule of Law in the Western Balkans: Call for a Revolution against Particularism" (Forcimi i shtetit ligjor në Ballkanin Perëndimor, Thirrja për një revolucion kundër partikularizmit), BIEPAG, janar 2019, <http://biEPAG.eu/wp-content/uploads/2019/03/Strengthening-the-Rule-of-Law.pdf>



ndryshimi është i mundshëm madje edhe në kushte të tilla (të pafavorshme). Kjo “fushë me rregulla të paqarta loje” lidhet me kodet e dobëta zgjedhore, me shpërdorimin e burimeve publike për qëllime elektorale, dhe me rritjen e përfaqësimit të partive në pushtet në mediat e sponsorizuara nga shteti apo të lidhura me shtetin. Pengesa më e madhe ndaj zgjedhjeve të lira dhe të ndershme konsiderohet presioni ndaj votuese (p.sh., nëpërmjet premtimeve apo kërcënimit për vendin e punës). Megjithatë, pjesa më e madhe e të anketuarve thanë se nuk e kishin përjetuar kurrë një gjë të tillë. Në një farë mase, kjo mund të interpretohet edhe si frikë e prezantimit të modeleve të tilla, gjë që mund të sjellë si pasojë humbjen e privilegjeve apo edhe hakmarrjen.

Sondazhet e opinionit shpesh tregojnë se besimi i qytetarëve tek institucionet është i ulët, kryesisht për shkak të situatës së pakënaqshme në këto vende dhe ndjesia se jo të gjithë janë të barabartë para ligjit. Sondazhi ynë tregon se edhe opozita nuk gëzon shumë besim. Edhe pse janë mjaft të zhgënjyer me qeverinë, qytetarët shpesh nuk e shohin opozitën si alternativë të besueshme dhe, përveçse e kritikojnë atë çorganizimin e saj, qytetarët shprehin kundërshtimet e tyre që lidhen me mungesën e unitetit, të udhëheqjes dhe të kapaciteteve e programeve të përshtatshme të opozitës. Edhe pse në përgjithësi qytetarët nuk e mbështesin bojkotin zgjedhor si instrument të aftë për të sjellë ndryshimin e vërtetë, opinionet ndryshojnë nga një vend në tjetrin, në varësi të efektivitetit të këtij instrumenti deri tani. Kështu, mbështetja për bojkotin është më e madhe, p.sh., në Maqedoninë e Veriut sesa në Serbi, në varësi të përvojave më të fundit. Vota e qytetarëve që jetojnë jashtë shtetit të tyre amë është një temë që diskutohet shumë pak në debatin publik, shpesh për shkak të frikës se ndryshimet në këtë front mund të vënë në rrezik elitat politike në pushtet. Si pasojë,

nuk është për t'u habitur që qytetarët kanë mungesë informacioni për këtë çështje.

Më e rëndësishmja, analiza e paraqitur më sipër tregon se qytetarët mund të jenë më të angazhuar në procesin demokratik nga sa mendohet zakonisht. Të dhënat zyrtare, edhe kur duken të besueshme dhe transparente, nuk duhet të merren për të mirëqena. Pjesëmarrja në votime mund të jetë në fakt më e lartë se sa na bëjnë të mendojmë statistikisht zyrtare dhe ka hapësirë që kjo pjesëmarrje të rritet edhe më tej. Për më tepër, besimi tepër i lartë në procesin zgjedhor në Malin e Zi, dhe pjesërisht edhe në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut, pas rezultateve të zgjedhjeve, të cilat konfirmuan se një ndryshim i tillë është i mundur, nuk mund të ekzagjerohet. Nga ana tjetër, pjesëmarrja në mobilizimin e publikut nuk duket se ndjek të njëjtin ritëm (të paktën ende jo).<sup>19</sup>

Sigurisht që ndryshimi i klasës në pushtet nuk është i mjaftueshëm në vetvete. Nëse shumica e vjetër zëvendësohet nga një e re që vazhdon të njëjtat praktika, kjo mund të ketë pasoja të këqija – mundësisht duke sjellë edhe një tjetër periudhë të sundimit autoritar.<sup>20</sup> Prandaj, “ndryshueshmëria” e qeverisë është parakusht i rëndësishëm për demokratizimin, por kjo aftësi për ndryshim duhet të sjellë përmirësim të performancës së institucioneve dhe të pavarësisë së tyre që ndryshimi të ketë efekte pozitive afatgjata. Pavarësisht këtyre paralajmërimeve, gjetjet tona tregojnë se zgjidhja e “problemit të veprimit kolektiv” në Ballkanin Perëndimor mund të jetë më pak e vështirë nga sa parashikohet në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhje. Sapo të vihen në lëvizje ndryshimet, gama e asaj që bëhet e mundur mund të zgjerohet shumë shpejt në sytë e publikut. Sidoqoftë, pjesa e vështirë është pikërisht ai hapi i parë - si të bëhet kthesa?

## Methodology

Të dhënat parësore që përdoren në këtë analizë politikash të BiEPAG vijnë nga një sondazh i opinionit publik të kryer në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor në muajin tetor 2020. Sondazhi u krye me një kampion përfaqësues kombëtar prej 1,000 të anketuarish të moshës mbi 18 vjeç, nëpërmjet intervistave telefonike dhe online duke ndjekur këtë raport: Shqipëria (telefon + online, 90:10), Bosnje-Hercegovina (telefon + online, 80:20), Kosova (telefon, 100), Mali i Zi (telefon + online, 90:10), Maqedonia e Veriut (telefon + online, 90:10) dhe Serbia (telefon + online, 80:20). Rezultatet jepen në përqindje dhe janë subjekt i gabimeve të mëposhtme statistikore: Shqipëria ±3.39%, Bosnje-Hercegovina ±3.39 %, Kosova ±3.32%, Mali i Zi ±3.36%, Maqedonia e Veriut ±3.34 % dhe Serbia ±3.38%. Mbledhja e të dhënave u realizua nga Ipsos Strategic Marketing.

Fondi Evropian për Ballkanin 2020. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autor(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet dhe pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.

19 Një rrugë për hulumtime të mëtejshme është krahasimi i këtyre çështjeve me punën e bërë në vende të tjera, të tilla si hulumtimi i Michael Biggs që shpjegon mobilizimin në SHBA edhe kur kjo në dukje bie ndesh me problemin e veprimit kolektiv. Shih: Michael Biggs, “Positive feedback in collective mobilization: The American strike wave of 1886”, *Theory and Society*, 2003, Vol. 32, fq. 217–254.

20 Tena Prelec, “Regime Change and the Rule of Law: Serbia’s Lessons to Montenegro” (Ndryshimi i regjimit dhe shteti ligjor: Mësime nga Serbia për Malin e Zi), Politikon Network, dhjetor 2020 <https://politikon.me/2020/12/05/regime-change-and-the-rule-of-law-serbias-lessons-to-montenegro/>





<https://biepag.eu>

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotëron pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave.

Ky grup përbëhet nga hulumtues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Aktualisht, anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Vedran Džihić, Donika Emini, Dejan Jović, Marko Kmezić, Jovana Marović, Srđan Majstorović, Milan Nić, Zoran Nechev, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nicolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergi Vurmo, Jelena Vasiljević, dhe Natasha Wunsch.

[www.balkanfund.org](http://www.balkanfund.org)

**Fondi Evropian për Ballkanin** është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha kryesore - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritit në BE.

EFB mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platformën ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive, [aleksandra.tomanic@balkanfund.org](mailto:aleksandra.tomanic@balkanfund.org)

[www.suedosteuropa.uni-graz.at](http://www.suedosteuropa.uni-graz.at)

**Qendra për Studime të Evropës Juglindore** u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe edukimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar.

Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon konferenca dhe seminare ndërkombëtare rregullisht për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore.

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER, Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore, [florian.bieber@uni-graz.at](mailto:florian.bieber@uni-graz.at)

Kontakt: UNIV.PROF. DR. FLORIJAN BIBER, profesor studija Jugoistočne Evrope, [florian.bieber@uni-graz.at](mailto:florian.bieber@uni-graz.at)